

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 1640 Rep
Nr. 466/2 Kol.



PROKURE E POSACME

Sot, me date 21/09 /2007 (dy mijë e shtate) para meje Noteres Laura Pustina, anetare e dhomes se noterise Tirane, me seli ne Tirane, Rr. "Deshmoret e 4 Shkurtit", Pll.26/1, u paraqit personalisht:

z. Sotirios Kapotas, shtetas grek, i lindur ne Kalavryta, Greqi, me dt. 29.02.1960, dhe banues ne Angli, per identitetin e te cilit, une Noteria jam e sigurte, nepermjet pasaportes se tij personale AB 5415864, me zotesi te plote juridike per te vepruar;

I cili, m'u paraqit ne cilesine e administratorit te shoqerise tregtare "STREAM OIL & GAS" ltd, nje shoqeris e se drejtes angleze, e regjistruar ne Cayman Island, me date 11.06.2007, sipas regjistrimit me nr. W-K-188194; Personi i pranishem, meqenese nuk di shqip, komunikon personalisht me mua noteren ne gjuhen angleze; dhe me kerkon perpilimin dhe noterizimin e prokures se posacme me permbajtje si vijon :

"Une nenshkruesi, ne cilesine e administratorit te shoqerise tregtare "STREAM OIL & GAS" ltd, emeruj Perfaqesuesen time juristen zj. Joana Qeleshi, shtetase shqiptare, te ciles i jap te drejte dhe kopetence te plote qe ne emer e per llogarine time te kryeje te gjitha formalitetet e duhura ligjore si dhe te plotesoje dhe te nenshkruaje cdo dokument qe mund t'i kerkohet, per te regjistruar ne Shqiperi Degen e shoqerise tregtare "STREAM OIL & GAS" ltd, si Subjekt juridik dhe fiskal, perkatesisht prane Qendres Kombetare te Regjistrimit (QKR) dhe ne cdo zyre tjeter publike te nevojshme per zhvillimin e aktivitetit ekonomik te Deges, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Per kete qellim e porositura prej meje ka te drejte te operoje personalisht vete, duke u paraqitur vete dhe/ose personat e autorizuar prej saj ne institucionet perkatese publike per te regjistruar shoqerine.

Une te gjitha veprimet e saj qe lidhen me sa me siper i konsideroj te drejta e te mireqena me fuqi te plote ligjore e te pakontestueshme njelloj sikur te ishim vete prezent, me anen e kesaj prokure te posacme te hartuar me vullnetin tim te lire e te plote. Kjo prokure eshte e vlefshme deri sa te revokohet ne menyre te ligjshme nga porositesi dhe te komunikohet ligjerisht revokimi i saj ne baze te nenit 76 te Kodit Civil.

Per efekt te ligjes une noterja perpiloj kete prokure te posacme ne baze te Kodit Civil te R.Sh neni 70 e ne vijim, ia lexoj porositesit ne gjuhen angleze permbajtjen e kesaj prokure te posacme, e cila mbasi u gjet sipas vullnetit te tyre te lire dhe te plote u nenshkrua prej tyre dhe u vertetua prej meje ne baze te ligjes Mbi Noterine.

I perfaqesuari
Sotirios Kapotas
Administrator i "STREAM & OIL " LTD

NOTERE

Laura Pustina

